


**Autorja e mirënjohur Helena Kadare, e ftuar nderi në Fakultetin e Shkencave të Edukimit në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”**

Në kuadër të 16 ditëve të sensibilizimit kundër dhunës me bazë gjinore e ftuar nderi në Fakultetin e Shkencave të Edukimit, autorja e mirënjohur Helena Kadare, ka përcjellë mesazhe sensibilizimi dhe solidariteti.

*“Ne sot duhet të thyejmë stereotipet e krijuara në shoqëri për gruan.  
Të trajtojmë këtë plagë të hershme dhe ekzistuese në shoqërinë njerëzore.  
Një botë që respekton gjininë femërore është më pranë perfeksionizmit.”*





Në një bashkëbisedim të ngrohtë, për të ndarë me  
ne, një mesazh frymëzues rreth pozitës,  
kontributit dhe vlerave të gruas në shoqëri, e  
ftuara e veçantë e Fakultetit të Shkencave të  
Edukimit, Znj. **Helena Kadare**, autore e disa  
vëllimeve letrare, dhe përkthyesë e veprave të  
shkrimtarëve të njohur botërorë. Romanet dhe  
tregimet e saj kanë në qendër përjetimet  
vajzërore, të nënës dhe bashkëshortes, të cilat  
ashtu si vetë personi i saj rrezatojnë mirësinë,  
fisnikërinë, përkushtimin dhe urtësinë e gruas.

Ju presim më datë 1 dhjetor, ora 11.00  
Auditori 111, Fakulteti i Shkencave të Edukimit